



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATE/A:	09.09.2026
REFERENC-Ë:	26/3562/MMPH
PËR/ZA/TO:	"EURO LINDI" SH.P.K. Bajë, Malishevë, Qendrën grumbulluese dhe çmontuese të automjeteve mbeturinë, komponentët e tyre dhe mbeturinave metalike në Bajë, Malishevë
CC:	Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për Leje Mjedisore
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Bajram Kafexholli, U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPH-së
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për ndërprerje të procedurës administrative

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) ka kontrolluar kërkesën për pajisje me Leje Mjedisore, me nr. prot. 26/3562/MMPH, datë 25.06.2026, të parashtruar nga operatori "EURO LINDI" SH.P.K. Bajë, Malishevë, për qendrën grumbulluese dhe çmontuese të automjeteve mbeturinë, komponentët e tyre dhe mbeturinave metalike në Bajë, Malishevë.

MMPH, pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur dhe një sërë takimesh, ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur.

Bashkangjitur kësaj shkrese gjeni:

1. Vendimi për ndërprerje të procedurës administrative të kërkesës për pajisje me Leje Mjedisore për operatorin "EURO LINDI" SH.P.K. Bajë, Malishevë, për qendrën grumbulluese dhe çmontuese të automjeteve mbeturinë, komponentët e tyre dhe mbeturinave metalike në Bajë, Malishevë.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

*Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the
General Secretary*

Nr.: 26/3562/MMPH
Datë: 09.09.2026

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), Rregullores (QRK) Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, nenit 10, paragrafit 3 të Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, si dhe Udhëzimin Administrativ (MMPHI) Nr. 01/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ MMPHI- Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, nxjerr këtë:

V E N D I M

Operatorit "EURO LINDI" SH.P.K. Bajë, Malishevë, i ndërpritet procedura administrative për kërkesën për pajisje me Leje Mjedisore, me nr. prot. 26/3562/MMPH, datë: 25.06.2026, për qendrën grumbulluese dhe çmontuese të automjeteve mbeturinë, komponentët e tyre dhe mbeturinave metalike në ngastrën kadastrale nr. P-72316001-00346-0, P-72316001-00347-0, zona kadastrale Banjë, Komuna e Malishevës.

A r s y e t i m

Pas pranimit të kërkesës për pajisje me Leje Mjedisore me nr. prot. 26/3562/MMPH, datë: 25.06.2026, të operatorit "EURO LINDI" SH.P.K. Bajë, Malishevë, për qendrën grumbulluese dhe çmontuese të automjeteve mbeturinë, komponentët e tyre dhe mbeturinave metalike në Bajë, Malishevë, Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për Leje

Faqe 2 nga 3



Mjedisore ka kontrolluar lëndën në bazë administrative dhe në përputhje me nenin 10, paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 04/2022, ka kërkuar nga operatori plotësim të dokumenteve me datë 03.07.2026 si në vijim:

- Certifikatën e përdorimit ose një dokument nga Komuna (Leje për ushtrimin e veprimtarisë me numrin e ngastrave), në përputhje me Vendimin për Pëlqim Mjedisor dhe kërkesën për pajisje me Leje Mjedisore;
- Planin e veprimit për menaxhimin e mbeturinave.

Operatori nuk ka sjellur dëshmi për plotësimin e dokumentacionit shtesë të kërkuar.

Komisioni për Leje Mjedisore ne takimin e mbajtur me datë 25.08.2026, konstatoi se operatori "EURO LINDI" SH.P.K. Bajë, Malishevë, për qendrën grumbulluese dhe çmontuese të automjeteve mbeturinë, komponentët e tyre dhe mbeturinave metalike në Bajë, Malishevë, nuk i plotëson kriteret e parapara për fillimin e shqyrtimit të kërkesës për pajisje me Leje Mjedisore, pasi që nuk e ka kompletuar dokumentacionin e cekur me lartë në afatin kohorë të përcaktuar nenin 10 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.

Andaj bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, mbyll procedurën administrative në përputhje me nenin 10 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.

Shpjegim për palën: Dispozitivi i përcaktuar në vendim nuk sanksionon të drejtën e palës për ri aplikim sipas procedurës së rregullt.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Bajram Kafexholli

U.D i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPH-së

Vendimi i 'u dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës;
- DMM-së;
- Inspektoratit;
- Kabinetit të Ministrit
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPH-së;
- Arkivit të MMPH-së.